



Nr. 03/ZDP/VE/2011

Datë: 16 gusht 2011

Duke marrë parasysh kompetencat e Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës ("AAC") sipas nenit 14.1 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare" Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008, më tej "LAC"),

Në mbështetje të nenit 21.2 të LAC, dhe nenit 6.4 dhe 23.1 të Rregullores së brendshme të AAC-ë,

Duke marrë parasysh përgjegjësinë e AAC-së për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave fizikë dhe juridikë, si dhe palëve të interesuara të cilat mund të pretendojnë se janë dëmtuar nga një veprim, mosveprim, ose lëshim procedural ose material nga strukturat e AAC-së, nga një person juridik i cili vepron sipas autorizimit të AAC-së, apo një person juridik i cili mbikëqyret nga AAC,

Me qëllim të krijimit të mundësisë për kundërshtim të një veprimi, mosveprimi ose lëshimi me rrugë procedurale administrative brenda AAC-së, në pajtim me nenin 27.2 të LAC dhe Ligjit për Procedurën Administrative në fuqi,

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, merr këtë:

VENDIM

Neni 1

Themelohet Komisioni i Ankesave pranë AAC-së ("Komisioni") si strukturë e ndarë dhe e pavarur nga strukturat tjera të AAC-së. Komisioni do të ketë këtë përbërje:

- | | |
|-------------------------|---------------------|
| 1. Eset Berisha | Kryetar |
| 2. Lendita Kika-Berisha | Anëtar |
| 3. Arianit Islami | Anëtar |
| 4. Besnike Ukmata | Anëtar (alternativ) |
| 5. Kushtrim Musa | Anëtar (alternativ) |

Neni 2

2.1 Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit fillon nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi dhe do të zgjasë tre (3) vjet, me mundësi vazhdimi. Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit është i lidhur me funksionin të cilin ata e mbajnë në AAC.

2.2 Përfundimisht, mandati i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit mund të ndërpritet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm për arsye të parapara me ligj.

2.3 Gjatë seancave të tij, Komisioni do të funksionojë në përbërje të kryetarit dhe dy anëtarëve. Komisioni do të ketë kompetencë të shqyrtojë dhe të vendosë në shkallë të dytë ankesat kundër:

- a) të gjitha veprimeve, mosveprimeve, lëshimeve procedurale apo materiale si dhe vendimeve të lëshuara nga strukturat e AAC-së sipas autorizimeve të dhëna nga LAC, e të cilat prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në një mënyrë tjetër, interesat e ndonjë personi fizik apo juridik;
- b) të gjitha veprimeve, mosveprimeve, lëshimeve procedurale apo materiale si dhe vendimeve të lëshuara nga një person juridik i cili vepron sipas autorizimit të dhënë nga AAC-ja, në bazë të një vendimi apo akti nënligjor të lëshuar nga AAC-ja, e të cilat prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në një mënyrë tjetër, interesat e ndonjë personi fizik apo juridik;
- c) të gjitha veprimeve, mosveprimeve, lëshimeve procedurale apo materiale si dhe vendimeve të lëshuara nga një person juridik në përputhje me kompetencat dhe fushëveprimin e tij të paraparë me ligj apo ndonjë akt tjetër nënligjor, përderisa fushëveprimi i tij i nënshtrohet mbikëqyrjes së AAC-së sipas LAC, dhe të cilat prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në një mënyrë tjetër, interesat e ndonjë personi fizik apo juridik.

2.4 Komisioni gjithashtu do të ketë kompetencë të shqyrtojë dhe vendosë në shkallë të parë ankesat lidhur me moslëshimin e ndonjë vendimi nga strukturat e AAC-së, moslëshimin e ndonjë vendimi nga një person juridik i cili vepron sipas autorizimit të AAC-së, apo një personi juridik i cili mbikëqyret nga AAC.

Neni 3

3.1 Gjatë ushtrimit të funksionit të tij, Komisioni do të veprojë në përputhshmëri të plotë me dispozitat përkatëse për ankimime administrative sipas Ligjit në fuqi për procedurën administrative.

3.2 Komisioni do të ketë të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e provave, dëshmi, lëshimin e urdhrave për paraqitje, kërkimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm lidhur me vendosjen përfundimtare të çështjes e cila është objekt shqyrtimi para Komisionit.

Neni 4

4.1 Të gjitha vendimet e Komisionit duhet të merren me shumicë votash. Të gjithë anëtarët dhe kryetari duhet të deklarojnë për apo kundër, abstenimet nuk lejohen. Vendimet do të hartohen në formën dhe mënyrën e paraparë me ligj dhe duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe anëtarët e Komisionit.

4.2 Vendimet e Komisionit janë të formës përfundimtare dhe të ekzekutueshme nga dita e hyrjes së tyre në fuqi, në përputhje me Ligjin në fuqi për procedurën administrative.

Neni 5

5.1 Në rast të paraqitjes së ndonjë konflikti interesi nga ana e ndonjë anëtari të Komisionit në ndonjë çështje e cila është objekt shqyrtimi dhe vendosjeje nga Komisioni, atëherë anëtari i Komisionit do të zëvendësohet nga njëri nga anëtarët alternativë nga neni 1.

5.2 Zëvendësimi i anëtarit me një anëtar alternative, si dhe zëvendësimi i kryetarit në rast ndonjë konflikti interesi, do të bëhet nga Drejtori i përgjithshëm.

Neni 6

Komisioni do të hartojë rregulla pune me qëllim të mbarëvajtjes së procesit të punës së tij dhe udhëzimit të nevojshëm për palët e interesit.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi më 22 gusht 2011.



Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm